



***RAPORT** i audituesit te pavarur*

*mbi auditimin e Pasqyrave financiare te vitit ushtrimor 2011.
Partia Socialiste e Vertete 91.(PSV 91)*

PER KQZ TIRANE.

***Ekspert Kontabel i Regjistruar**
Lulash PJETERNIKAJ
Tirane.*



Raport i Audituesit te pavarur

mbi auditimin e pasqyrave financiare , fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga Partia Socialiste e Vertet 91.per vitin udhtrimot 2011

KOMISJONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE!

Te nderuar zoterinj

Une kam mare nga Ju misionin per te audituar pasqyrat financiare te subjektit Partia Socialiste e Vertete 91. te cilat perfshijne bilancin kontabel ne date 31.12.2011, pasqyrat perkatese te ardhurave e shpenzimeve , pasqyren e fluksit te parase dhe pasqyren e ndryshimit ne kapitalet e veta per ushtrimin e mbyllur ne ate date,si dhe nje permbledhese te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime spjeguese e te tjera anekse .

. Pergjegjesia e Drejtimit

Drejtimi eshte pergjegjes per pergaditjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me standartet kombetare te kontabilitetit dhe te raportimit financiar si dhe me ligjin nr.8580,date10.02.2000,ndryshuar me Ligjin nr.10374 date 10.02.2011."Per Partite Politike" dhe Ligjit nr.9228 dt29.04.2004,"Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

.Kjo pergjegjesi perfshin : Hartimin ,venjen ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem per pergaditjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel si dhe per te bere cmuarjet kontabel qe jane te aresyeshme per rethanat e dhena

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone si auditues eshte qe te shprehim nje opinjon per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone.

Une u perpoqa per te kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.Keto standarte kerkojne qe ne te planifikojme dhe te kryejme auditimin tone per te pasur nje siguri te aresyeshme se kjo pasqyre nuk permban anomali materiale .

Auditimi perfshin shqyrtimin mbi bazen e testeve ,te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare .

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare .Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit . paraqitjen me sinqeritet te

2


pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtateshme per rrethanet.

Auditimi perfshin gjithashtu vleresimin e pershtateshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe vleresimet e rendesishme e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyres.

Subjekti Partia Socialiste e Vertet 91 sipas deklarimit te tij per vitin 2011 nuk ka pasur te ardhura dhe shpenzime ,si dhe nuk ka paraqitur pasqyra financiare si dhe nuk eshte i paisur me NIPT nga organet tatimore:

Opinion i Audituesit

Per pasqyrat financiare (01.01.2011- 31.12.2011) te Subjektit Partia Socialiste e Vertete 91 , nuk mund te shpreh opinion.

Tirane 22.06.2012

Ekspert Kontabel i Regjistruar

Lulash PJETERNIKAJ lic.109,dt 21.12.2000.
Kthesa e Kamzes ,Pallatet Maleziane Tirane.

